

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
PAII.-KŽII. Nr. 5/2015
26 tetor 2015
Prishtinë

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës, në kolegjin e përbërë nga Gjyqtarja e EULEX-it Elka Filcheva-Ermenkova, kryetare e kolegjit, Gjyqtarja e EULEX-it Anna Adamska-Gallant dhe Gjyqtarja e Gjykatës Supreme Gyltene Sylejmani si anëtare të kolegjit, të ndihmuar nga Zyrtari ligjor i EULEX-it Holger Engelmann si procesmbajtës, në lëndën penale kundër:

A. [REDAKTUAR] mashkull, emri i babait [REDAKTUAR] emri i nënës [REDAKTUAR] i lindur më [REDAKTUAR] në Korroticë të Epërme, komuna e Glllogocit, Kosovë, vendbanimi i fundit në lokacionin e njëjtë, shqiptar i Kosovës, i martuar, ka dy fëmijë, ka mbaruar shkollën e mesme, me profesion tregtar, me gjendje të dobët financiare, i padënuar më parë;
Në paraburgim prej 22 majit 2009;

I akuzuar me aktakuzën PP. Nr. 465-6/2009, të datës 13 gusht 2009, të paraqitur pranë shkrimores së Gjykatës Themelore në Prishtinë, e vërtetuar me aktvendimin KA. Nr. 348/09, të datës 5 tetor 2009, për veprat penale:

1. **Vrasje e rëndë** në shkelje të nenit 147 paragrafit 1 pikës 9 të Kodit Penal të Kosovës¹ (tani e tutje KPK) dhe
2. **Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve** në shkelje të nenit 328 paragrafit 2 të KPK-së;

Me aktgjykimin e shkallës së parë P.-Kr. Nr. 383/2009 të Gjykatës Themelore të Prishtinës, të datës 9 shtator 2014, i pandehuri është shpallur **fajtor** për kryerjen e veprave penale **Vrasje e rëndë** sipas nenit 147 pikës 9 të KPK-së dhe **Posedim i paautorizuar e armëve** sipas nenit 374 paragrafit 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës² (tani e tutje KPRK). Për veprën e parë ai është **dënuar me njëzet e pesë (25) vite burgim afatgjatë** dhe për veprën e dytë me **dy (2) vite burgim**, dhe me **dënim unik prej njëzet e pesë (25) viteve burgim**.

Pas ankesës së paraqitur nga Prokurori i shtetit më 24 tetor 2014 dhe ankesës së paraqitur më 27 tetor 2014 nga avokati mbrojtës Destan Rukiqi në emër të pandehurit A. [REDAKTUAR] Gjykata e Apelit me aktgjykimin PAKR. Nr. 547/2014, të datës 12 qershor 2015, ka

¹ I lëshuar si 'Kodi i përkohshëm Penal i Kosovës, i nxjerrë si Rregullore e UNMIK-ut 2003/25, i datës 6 korrik 2003, i riemëruar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-002, në fuqi deri më 31 dhjetor 2012

² Ligji nr. 04/L-082, i datës 20 prill 2012, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 19, 13 korrik 2012, në fuqi prej 1 janarit 2013.

refuzuar ankesat si të pabazuara dhe ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Duke vendosur lidhur me ankesë në paraqitur më 4 shtator 2015 nga avokati mbrojtës D [REDACTED] R [REDACTED] në emër të pandehurit A [REDACTED] C [REDACTED] kundër aktgjykimin të lartpërmendur të Gjykatës së Apelit, gjithashtu duke pasur parasysh propozimin mbi ankesën të paraqitur më 28 shtator 2015 nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit (ZPSHK).

Pas këshillimit dhe votimit të mbajtur më 23 dhe 26 tetor 2015, sipas nenit 430 paragrafit 1 nën-paragrafit 1 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës¹ (tani e tutje: KPPK) *mutatis mutandis*, në lidhje me nenin 407 paragrafin 2, 403 nën-paragrafin 1.2 të KPP-së, kolegji lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

Ankesa e paraqitur më 4 shtator 2015 nga avokati mbrojtës në emër të të pandehurit A [REDACTED] C [REDACTED] kundër aktgjykimin PAKR. Nr. 547/2014 të Gjykatës së Apelit, të datës 12 qershor 2015, pranohet pjesërisht. Gjykata Supreme e Kosovës ndryshon aktgjykimin P-Kr. Nr. 383/2009, të datës 9 shtator 2014 sa i përket A [REDACTED] C [REDACTED] si në vijim:

1. A [REDACTED] C [REDACTED] është fajtor sepse më 22 maj 2009 rreth orës 13:40, në fshatin Zabel i Ulet, në Komunën e Glllogocit, afër xhamisë, në hakmarrje për dëmin e perceptuar të shkaktuar ndaj tij nga tani i ndjeri R [REDACTED] A [REDACTED] përkatësisht se kinse R [REDACTED] A [REDACTED] ishte shkaktari i shkatërrimit të familjes së të pandehurit; me armë zjarri të nojtit AK-47, kalibër 7.62 mm. me numër serik nr. 09809-84; ai, i pandehuri A [REDACTED] C [REDACTED] qëllimisht ka privuar R [REDACTED] A [REDACTED] nga jeta e tij duke e qëlluar katër herë në pjesët vitale të trupit të tij dhe ky vepër është cilësuar si vrasje sipas nenit 146 të KPK-së, dhe për këtë vepër penale sipas nenit 146 të KPP-së është dënuar me 17 (shtatëmbëdhjetë) vjet burgim;
2. Në përputhje me nenin 3 nën paragrafët 1.1.10 dhe 1.2.5 të Ligjit për Amnistinë të 11 korrikut 2013 (Ligji Nr. 04/L-209), akuza kundër A [REDACTED] C [REDACTED] për veprën penale Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 paragrafi 2 i KPK-së (pika 2), hedhet poshtë;
3. Në përputhje me nenin 73 paragrafin 1 të KPK-së, koha që A [REDACTED] C [REDACTED] e kaluar në paraburgim prej 22 majit 2009 deri 25 tetor 2015 do të përfshihet në dënimin me burgim ndaj tij.

PJESA E MBETUR e aktgjykimin të kundërshtuar, VËRTETOHET.

¹ I lëshuar si 'Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale i Kosovës, i nxjerrë si Rregullore e UNMIK-ut 2003/26, i datës 6 korrik 2003, i riemëruar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-003, në fuqi deri më 31 dhjetor 2012

ARSYETIM

I. Historia e procedurës

Më 22 maj 2009, në fshatin Zabel i Ulët, në Komunën e Glogocit, para xhamisë së fshatit, R. [REDAKTUAR] vjeçri i të pandehurit A. [REDAKTUAR] C. [REDAKTUAR] është qëlluar katër herë me pushkë automatike AK-47, duke e lënduar për vdekje. Ai ka vdekur në vend. Pas bastisjes së shtëpisë së të pandehurit më vonë atë ditë është gjetur pushka automatike e llojit AK-47, për të cilën nuk kishte autorizim.

Në të njëjtën ditë, të pandehurit A. [REDAKTUAR] C. [REDAKTUAR] dhe R. [REDAKTUAR] O. [REDAKTUAR] janë arrestuar; kundër tyre është caktuar paraburgimi. I pandehuri C. [REDAKTUAR] në nga atëherë ka qenë në paraburgim; herën e fundit paraburgimi i tij është vazhduar me shpalljen e aktgjykimit të shkallës së parë më 9 shtator 2014 me anë të aktvendimit të Gjykatës Themelore të Prishtinës, derisa aktgjykimi të bëhet i formës së prerë. (R. [REDAKTUAR] O. [REDAKTUAR] është liruar më 14 qershor 2014).

Më 24 maj 2009, policia ka ngritur kallëzimin penal nr. 2009-AG-0424 pranë Prokurorisë së Qarkut në Prishtinë.

Aktvendimi mbi fillimin e hetimeve kundër dy të pandehurve PP. 465-6/2009 mban datën 26 maj 2009.

Më 13 gusht 2009, Prokuroria ka ngritur aktakuzën PP. Nr. 465-6/2009, duke e akuzuar A. [REDAKTUAR] C. [REDAKTUAR] për veprat penale e përshkruara më lart dhe R. [REDAKTUAR] O. [REDAKTUAR] për dhënie të ndihmës në kryerjen e veprës penale Vrasje e rëndë.

Më 5 tetor 2009, Gjykata e Qarkut në Prishtinë ka konfirmuar aktakuzën. Më 2011 ka filluar shqyrtimi gjyqësor para një kolegji të përbërë nga gjyqtarët vendorë.

Sidoqoftë, për faktin se lënda nuk ka përparuar në mënyrë të kënaqshme, më 8 tetor 2013, me kërkesë të familjes në atë kohë të pandehurit O. [REDAKTUAR] me vendimin 2013.OPEJ.0198-002 lënda i është caktuar gjyqtarëve të EULEX-it.

Shqyrtimi gjyqësor para kolegjit të Gjykatës Themelore të Prishtinës i përbërë nga dy gjyqtarë të EULEX-it dhe një gjyqtari vendor është mbajtur më 15, 18 nëntor 2013, 11 dhjetor 2013, 17, 21, 23 janar, 13 shkurt, 7 mars, 11 prill, 2 korrik dhe 5 shtator 2014. Aktgjykimi është shpallur më 9 shtator 2014.

Me aktgjykimin P.-Kr. Nr. 383/2009, të datës 9 shtator 2014, i pandehuri A. [REDAKTUAR] C. [REDAKTUAR] është shpallur fajtor për kryerjen e veprave penale Vrasje e rëndë sipas nenit 147 pikës 9 të KPRK-së dhe Posedim të paautorizuar të armëve sipas nenit 374 paragrafit 1 të KPRK-së. Për veprën e mëparshme është dënuar me njëzet e pesë (25) vite burgim afatgjatë dhe për veprën e dytë penale me dy (2) vite burgim, me dënim unik prej njëzet e pesë (25) viteve burgim.

I pandehuri R. [REDAKTUAR] O. [REDAKTUAR] është liruar.

Gjithashtu, gjykata ka urdhëruar konfiskimin dhe shkatërrimin e pushkës automatike të llojit AK-47, me numër serik nr. 09809-84 dhe llogaritjen e paraburgimit nga 22 maji 2009 deri më 9 shtator 2014, për [REDAKTUAR] C. [REDAKTUAR]

I pandehuri [REDACTED] është urdhëruar që t'i paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 100 Euro.

Pas ankesave të paraqitura më 27 tetor 2014 nga avokati mbrojtës Destan Rukiqi në emër të pandehurit A [REDACTED] C [REDACTED] dhe më 24 tetor 2014 nga Prokuroria, Gjykata e Apelit ka mbajtur seancë më 10 qershor 2015, ka mbajtur këshillimin edhe votimin më 12 qershor 2015. Me aktgjykimin e saj PAKR. Nr. 547/2014, të datës 12 qershor 2015, ka refuzuar ankesat si të pabazuara dhe ka vërtetuar aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Themelore të Prishtinës.

Më 4 shtator 2015, avokati mbrojtës Destan Rukiqi në emër të pandehurit A [REDACTED] C [REDACTED] ka paraqitur ankesë kundër aktgjykimit të lartpërmendur të Gjykatës së Apelit.

Më 28 shtator 2015, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit ka paraqitur propozimin e saj në ankesë, duke propozuar që ankesa të refuzohet si e pabazuar.

II. Propozimet e palëve

I. Ankesa e paraqitur nga avokati mbrojtës në emër të pandehurit A [REDACTED] C [REDACTED]

Avokati mbrojtës kundërshton aktgjykimin e Gjykatës së Apelit me anë të të cilit është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore të Prishtinës P.-Kr. 383/2009 i datës 9 shtator 2014, mbi bazën e shkeljeve substanciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit të gabuar mbi sanksionet penale.

Në veçanti, në ankesë pretendohet se aktgjykimi e tejkalon aktakuzën kur i cilëson motivet e të pandehurit për vrasjen e viktimës si hakmarrje e paskrupullt dhe motive tjera të ulëta. Viktima e ndjerë ka qenë armiqësor ndaj të pandehurit, motrave të tij dhe anëtarëve të tjerë të familjes për një kohë të gjatë. Ai kishte ndërhyrë në jetën e tij martesore dhe familjare. Aktakuza kishte akuzuar vetëm të pandehurin C [REDACTED] për privimin e R [REDACTED] A [REDACTED] nga jeta nga hakmarrja e paskrupullt. Duke i shtuar motivet e tjera të ulëta, aktgjykimi i kontestuar e tejkalon aktakuzën.

Aktgjykimi nuk është përpiluar në përputhje me nenin 370 të KPP-së. Atij i mungon data e përpilimit të tij; dispozitivit i mungon përshkrimi i motiveve se pse A [REDACTED] C [REDACTED] ka privuar nga jeta viktimën dhe gjithashtu përshkrimin e elementeve objektive dhe subjektive të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve në shkelje të nenit 374 paragrafit I të KPRK-së.

Aktgjykimit i mungon arsyetimi për sanksionet individuale të shqiptuara për secilën veprë penale si dh për caktimin e dënimit unik. Nuk i ka vlerësuar të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese. Në veçanti, ka dështuar që të marrë parasysh gjendjen emocionale të të pandehurit sipas raportit të ekspertit të psikiatrisë, gjendjen e tij familjare, vdekjen, në kohën e fundit, të nënës dhe babait të tij, fëmijët e tij nën moshën madhore, kohën e gjatë të kaluar në paraburgim dhe vonesën e konsiderueshme të përparimin e procedurës penale.

Aktgjykimi është i paqartë, dispozitivi është kundërtënës me vetveten dhe me arsyetimin. Në dispozitiv përmendet se A. C. ka kryer veprat e përshkruara në bashkëkryerje, kurse asgjë nuk është cekur në lidhje me bashkëkryerësit e pretenduar.

Në dispozitiv janë përshkruar vetëm elementet objektive të veprës penale Vrasje, kurse fare nuk janë përmendur elementet subjektive të cilat kërkohen sipas nenit 147 pikës 9 të KPK-së. Sidoqoftë, në arsyetim aktgjykimi konstaton se akti është kryer nga hakmarrja e paskrupullt dhe nga motivet e tjera të ulëta.

Në ankesë theksohet se gjetjet faktike të gjykatës mbështesin vetëm shpalljen fajtor për vrasje sipas nenit 146 të KPK-së.

Avokati mbrojtës pohon se ndërhyrja e për një kohë të gjatë e të ndjerit R. A. në jetën familjare të të pandehurit C. presioni i tij ndaj gruas së tij, grindjet e vazhdueshme me atë dhe marrëdhëniet armiqësore me të pandehurin për një kohë të gjatë kanë përbërë bazën për paqëndrueshmërinë emocionale të të pandehurit dhe tolerancën e tij të zvogëluar e cila ka çuar në vrasje.

Në rast se gjykata gjen se viktima është privuar nga jeta si hakmarrje për marrëdhëniet e këqija në mes të pandehurit dhe viktimës së ndjerë, kjo së paku nuk e përmbush kriterin e "paskrupullsisë".

Gjykata nuk ka qenë e autorizuar të caktojë "dënimin unik prej 25 (njëzet e pesë) viteve burgim" pasi që neni 71 paragrafi 2 nën-paragrafi 1 i KPP-së e përcakton si rregull se "nëse për ndonjërin prej veprave penale gjykata ka shpallur dënimin me burgim afatgjatë, atëherë e shqipton vetëm këtë dënim".

Përveç kësaj, sipas nenit 38 paragrafit 1 të KPK-së, dënimi me burgim nuk mund të shqiptohet në kohëzgjatje më pak se pesëmbëdhjetë ditë e as më tepër se njëzet vjet.

Lidhur me dënimin për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve në shkelje të nenit 374 paragrafit 1 të KPRK-së, mbrojtja pohon se kjo veper përshihet në Ligjin për amnistinë dhe se akuza përkatëse duhet të hedhet poshtë.

Në ankesë është propozuar që të ndryshohet aktgjykimi i kundërshtuar, të ri-cilësohet vepra penale në Vrasje sipas nenit 146 të KPK-së dhe të shqiptohet një dënim më i butë në lidhje me veprën penale, të hedhet poshtë akuza për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve në shkelje të nenit 374 paragrafit 1 të KPRK-së, ose si alternativë, të anulohet aktgjykimi i kundërshtuar dhe lënda të kthehet në rigjykim.

1. Përgjigja e Kryeprokurorit të Shtetit

ZPShK-ja e konsideron ankesën e avokatit mbrojtës si të pabazuar. Nuk ka asnjë shkelje të dispozitave të procedurës penale apo shkelje të ligjit penal; gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë. Dënimi i shqiptuar reflekton peshën e veprës penale, intensitetin, rrezikun dhe karakteristikat personale të të akuzuarit, rrethanat dhe mënyrën e kryerjes së veprës penale si dhe rrethanat rënduese dhe lehtësuese.

Dispozitivi dhe i tërë aktgjykimi janë në përputhje me brendinë dhe nuk e tejkalon akuzat në aktakuzë.

ZPShK-ja propozon që ankesa të refuzohet si e pabazuar.

III. Gjetjet e Gjykatës Supreme

Ankesa është paraqitur me kohë, është e pranueshme dhe pjesërisht e bazuar.

I. Pranueshmëria

Në bazë të zbatimit *mutatis mutandis* të nenit 430 paragrafit 1 nën-paragrafit 1 të KPPK-së, kolegji gjen se ankesa e të pandehurit është e pranueshme.

Gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e saj P.-Kr. Nr. 383/2009, të datës 9 shtator 2014, ka dënuar të pandehurin A. C. me burgim afatgjatë në periudhë prej 25 (njëzet e pesë) viteve për veprën penale Vrasje e rëndë dhe Gjykata e Apelit në aktgjykimin e apeluar PAKR. Nr. 547/2014, të datës 12 qershor 2015, ka vërtetuar këtë aktgjykim, me të cilin ishte shqiptuar burgimi afatgjatë.

Gjykata e shkallës së parë, me burgimin afatgjatë, për veprën penale Vrasje e rëndë ka shqiptuar një lloj të dënimit i cili më tutje nuk ekziston me kodin e ri penal, KPRK-në. Kodi i vjetër i Procedurës Penale, KPPK-ja, në nenin 430 paragrafin 1 nën-paragrafin 1 të KPPK-ës ka ofruar, për lëndën se ky lloj i dënimit shqiptohet apo vërtetohet nga gjykata e shkallës së dytë, garanci procedurale të një mjeti të rregullt juridik shtesë - mundësinë që të paraqitet ankesë kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë.

KPP-ja e re në nenin 407 paragrafin 1 të KPP-së lejon ankesën kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit vetëm në rast se

"...Gjykata e Apelit e ndryshon aktgjykimin lirues të gjykatës themelore dhe e zëvendëson me aktgjykim dënues për të akuzuarin ose kur me aktgjykimin e Gjykatës Themelore, ose Gjykatës së Apelit i është shqiptuar dënimi me burg të përjetshëm."

Të dy instancat paraprake kanë zbatuar drejtë kodin e ri të procedurës, KPP-ja e cila nuk përmban një dispozitë e cila në mënyrë eksplicite lejon ankesën kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë për një lëndë ku është shqiptuar dhe vërtetuar burgimi afatgjatë.

Në bazë të të drejtës për mjete juridike dhe parimit të ligjshmërisë, siç është përcaktuar me nenet 32 dhe 33 paragrafin 4 të Kushtetutës së Kosovës si dhe nenin 7 paragrafin 1 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (tani e tutje KEDNj), kolegji gjen se ndryshimi *ex post facto* në ligjin e procedurës, i cili ka ndodhur pas kryerjes së veprës penale, nuk mund ta privojë të pandehurin nga garancia procedurale e përcaktuar me ligjin e procedurës në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale.

KPPK-ja është hartuar që të përputhet në mënyrë të përkryer me KPK-në që ka qenë në fuqi në të njëjtën kohë. Zbatimi i dispozitave kalimtare në kodin e ri të procedurës, të cilat përcaktojnë zbatimin e KPP-së për lëndët kur vepra penale është kryer para hyrjes në fuqi të

KPRK-së dhe është dashur të dënohet sipas ligjit të vjetër material (KPK-së), mund të çojë në situata ku përputhja në mes të ligjit të procedurës me ligjin material nuk është e përkryer sikur në këtë rast. Ligji i ri material penal i cili ka hyrë në fuqi në të njëjtën kohë sikur ligji i ri i procedurës nuk e njeh më tutje llojin e dënimit të burgimit afatgjatë. (Në vend të kësaj ka përcaktuar kategorinë e re të burgimit të përjetshëm si formën më të ashpër të dënimit). Ligji i ri i procedurës nuk ka më dispozita në lidhje me kategorinë e burgimit afatgjatë. Lejon ankesat kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit vetëm në rrethanat e përshkruara në nenin 407 paragrafin 1 të KPP-së, si është cituar më lart.

Pasi që interpretimi strikt i fjalëpërfjalshëm i kodit të ri të procedurës do të çonte në privimin retroaktiv të garancisë procedurale të një shqyrtimi shtesë i cili ishte ofruar me ligjin i cili ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, Gjykata Supreme e Kosovës përcakton se për t'iu shmangur një ndryshimi të tillë *ex post facto* të ligjit në dëm të të pandehurit, dispozita përkatëse e nenit 430 paragrafit 1 nën-paragrafit 1 të KPPK-së duhet të zbatohet *mutatis mutandis* për lëndët në të cilat është shqiptuar apo vërtetuar burgimi afatgjatë nga gjykata e shkallës së dytë.

2. Meritat e ankesës

Sipas nenit 394 paragrafit 1 të KPP-së, Gjykata Supreme është dashur të shqyrtojë pjesët e aktgjykimit të kontestuar të cilat janë kundërshtuar me ankesë dhe të përcaktojë ka pasur ndonjë shkelje të përmendur në nën-paragrafët 1.1. deri 1.4.

a. Vërtetimi i gabuar po jo i plotë i gjendjes faktike

Kolegji gjen se aktgjykimi i kontestuar ka dështuar që të përcaktojë se i pandehuri ka privuar nga jeta viktimën R. A. nga hakmarrja e paskrupullt dhe nga motive të tjera të ulëta. PA e përcaktuar se keto elemente të *mens rea* kanë ekzistuar, akti i vrasjes së viktimës nuk mund të cilësohet si Vrasje e rëndë sipas nenit 147 paragrafit 1 pikës 9 të KPK-së. Gjetjet e trupit gjykues janë të mjaftueshme për ta cilësuar veprën e kryer penale si Vrasje në shkellje të nenit⁴. Gjykata Supreme, sipas nenit 403 paragrafit 1 të KPP-së, ka korrigjuar mangësitë dhe ka ndryshuar aktgjykimin e kundërshtuar, në përputhshmëri.

Në ankesë pohohet se viktima e ndjerë ka qenë armiqësor ndaj të pandehurit, se vazhdimisht kishte ndërhyrë në marrëdhëniet me gruan dhe familjen e tij dhe se ai kishte qenë arsyeja kryesore për ndarjen e të pandehurit nga gruaja – pretendim të cilin i pandehuri tashmë e kishte bërë në deklaratat e tij të mëparshme gjatë hetimit dhe shqyrtimit gjyqësor.

Gjykata Supreme vëren se aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Themelore në dispozitiv fare nuk përmend motivet apo elementet e cilësuar subjektive të të akuzuarit. Vetëm ishte formuluar se i pandehuri “me dashje kishte përdorur AK-47” dhe se kishte privuar viktimën nga jeta “me dashje direkte”.

Aktgjykimi i kontestuar në arsyetim konkludon se motivi i të pandehurit për vrasjen ishte hakmarrja e paskrupullt dhe motivet e ulëta (par.86, faqe 37). Aktgjykimi pohon se:

⁴ Mendimi pjesërisht mospajtues i Gjyqtarës Elka Filcheva-Ermenkova mbi këtë çështje, i bashkangjitur në këtë aktgjykim.

"I pandehuri vrau babanë e gruas së tij sepse viktimi i jepte mbështetje të bijës së tij. Në mendjen e të pandehurit viktimi ishte shakatar kryesor i ndarjes me gruan e tij. Në anën tjetër, provat e lëndës tregojnë qartë se viktimi kurrë nuk i kishte bërë të pandehurit asnjë të keqe. Motivi i ulët i të pandehurit është shfaqur qartazi në tekstin e mesazhit SMS që ia kishte dërguar gruas së tij menjëherë pas vrasjes."

Gjykata e Apelit në aktgjykimin e vet i konfirmoi këto gjetje duke shtjelluar (paragrafi i fundit në faqe 11):

"Kolegji vështron, nga vetë pranimi i avokatit mbrojtës në ankesën e tij, se Afrim CURRI ka privuar viktimën Ragip Ajazi nga jeta e tij "për hakmarrje" për shkak të marrëdhënieve të tyre armiqësore dhe për shkak se e mbante vjehrrin e tij përgjegjës për shkatërrimin e lidhjes së tij me gruan e tij. Gjykata e Apelit pajtohet me mendimin e trupit gjykues se privimi i viktimës nga jeta për këto arsye tregon një reagim ekstrem, tejet të shpërpjesëtuar dhe të pakthyeshëm, që karakterizon elementin e paskrupullt të krimit. Kjo është vërtetuar edhe me SMS-in e poshtër gjakftohtë që Afrim CURRI ia dërgoi Qefsere Ajazi menjëherë pas krimit."

Për të cilësuar aktin e vrasjes së viktimës si vrasje të rëndë në përputhje me nenin 147 paragrafin 1 pikën 9 të KPK-së kërkohet të identifikohen elementet cilësuese subjektive të hakmarrjes së paskrupullt dhe/ose të motiveve të tjera të ulëta.

Në përgjithësi është e pranueshme në të komentuarit e dispozitave në ligjet e tjera penale me formulime identike si në nenin 147 paragrafin 1 pikën 9 të KPK-së se vetë hakmarrja, përkatësisht kthimi i të keqes për të keqen e shkakuar, d.m.th. shkaktimi i dëmit për shkak të dëmit të vuajtur, si motiv për vrasje nuk mjafton që vepra penale ta merr formën e cilësuar. Vetëm vrasja e kryer nga hakmarrja e paskrupullt është vrasje e rëndë.

Për t'u kryer një vrasje nga hakmarrja e paskrupullt, duhet të ketë një mospërputhje domethënëse në mes të vrasjes dhe dëmit, që me anë të vrasjes është marrë hak. Një motiv i përshtatshëm për hakmarrje, dhe për hakmarrje të paskrupullt me anë të vrasjes, mund të mos jetë vetëm një vepër penale e kryer më parë ose një dëm i vërtetë por mund po ashtu të jetë një veprim thjesht i perceptuar si i dëmshëm nga kryerësi⁵.

Barra e të provuarit për elementet cilësuese subjektive i takon prokurorisë.

I pandehuri kishte pretenduar më parë gjatë shqyrtimit gjyqësor se Ragip Ajazi kishte qenë armiqësor në mënyrë aktive, kishte ndërhyrë vazhdimisht në jetën e familjes së tij dhe se ishte përgjegjës për dështimin e martesës së të pandehurit – pretendim i përsëritur edhe në ankesë.

Gjykata Themelore e konsideroi deklaratën e Afrim CURRI si "në përgjithësi të besueshme", me përjashtim të pjesës së deklaratës së tij "...kur orvatet ta përshkruajë viktimën si burimin e telasheve të tij dhe të shkurorëzimit me gruan e tij. Kjo është kundërshtuar nga deklaratat e Ragip Ajazi dhe deklarata e Miroslav, 1981".

⁵ Krahaso: Paragrafi 7 i Komentit të nenit 47 të Kodit Penal të Serbisë, SRZENTIC, Nikola, STAJIC, dr. Aleksandar, KRAUS dr. BOZIDAR, LAZAREVIC, dr. Ljubisa, DJORDJEVIC, dr. Miroslav, 1981 "SAVREMENA ADMINISTRACIJA", Beograd

Arsyetimi i aktgjykimit të Gjykatës Themelore nuk bën vlerësimin e motiveve për vrasjen në detaje të tjera.

Kolegji gjen se Gjykata e Apelit në aktgjykimin e kundërshtuar nuk ka arritur t'i paraqesë dhe arsyetojë faktet që do të tregonin përtej dyshimit të arsyeshëm se kishte një mospërputhshmëri domethënëse në mes të vrasjes dhe të dëmit të shkaktuar ndaj të pandehurit ose dëmit të perceptuar nga viktima e ndjerë. I pandehuri A. C. qartazi ka perceptuar të ndjerin R. A. si shakatarin kryesor për mosfunksionimin e martesës së tij. Për një kohë të gjatë ai ka menduar se i ndjeri R. A. po ndërhynte armiqësisht në familjen e tij dhe në marrëdhëniet e tij me gruan e tij. Perceptimi i tij ishte se viktima e kishte bindur vajzën e tij ta linte të pandehurin dhe fëmijët dhe të mos i kthehej atij, edhe pasi kishte kërkuar nga ajo ta bënte këtë.

Pavarësisht çështjes nëse i ndjeri late R. A. vërtetë kishte shkaktuar dëmin, është e qartë se i pandehuri ka perceptuar se ai e kishte bërë këtë. Me asnjë provë kjo nuk është kundërshtuar. Dëshmitari Q. M. vetëm ka dëshmuar se të dytë, i akuzuari dhe viktima e ndjerë R. A., kishin kontribuar në përpjekjet për pajtim. Përfundimi i nxjerrë nga Gjykata themelore, dhe i pranuar nga Gjykata e Apelit, se (par. 46, faqe 24): “Kjo dëshmi tregon se viktima R. A. nuk ishte pengesë për (a) marrëdhëniet e qëndrueshme në mes të Q. M. dhe A. C.” shkon përtej përmbajtjes së dëshmisë së dëshmitarit. Dëshmitari nuk ka deklaruar asgjë lidhur me ndikimin që viktima e ndjerë ka mundur të ketë në marrëdhënien më mes të të pandehurit dhe ish gruas së tij.

Perceptimi i të pandehurit se viktima e ndjerë duke ndikuar në vajzën e tij për prishjen e martesës dhe për ta lënë burrin dhe fëmijët e saj i ka shkaktuar dëm të rëndë dhe të riparueshëm është – në mungesë të provave që bindin ndryshe – duhet të pranohet.

Në bazë të Komentarit të nenit 47 të Kodit Penal të Serbisë⁶, motivet bazë si elemente cilësuese subjektive për vrasje të rëndë janë ato të cilat janë moralisht të padenja, në kundërtënie të rreptë me pikëpamjet morale të pranuar në shoqëri dhe që meritojnë dënim të posaçëm.

Edhe pse aktgjykimi i kundërshtuar në par. 86 në faqe 37 përmend “motivin e ulët” prapë nuk bën shtjellim në atë çështje.

I pandehuri padiskutueshëm e ka vrarë viktimën për hakmarrje. Megjithatë, këtë e ka bërë si reagim i dëmit të madh të perceptuar të shkaktuar ndaj tij dhe familjes së tij nga viktima e ndjerë. Gjetjet e gjykatës nuk mbështesin ekzistimin e motivit të hakmarrjes së paskrupullt ose të motive të tjera të ulëta. Rrjedhimisht, në mungesë të elementeve cilësuese subjektive, vepra penale e vrasjes së viktimës duhej të cilësohej si vrasje në shkelje të nenit 146 të KPK-së.

b. Shkeljet substanciale të dispozitave të procedurës penale

Gjykata Supreme gjen se aktgjykimi i kundërshtuar nuk përmban asnjë shkelje substanciale të dispozitave të procedurës penale.

⁶ Ibid.

Ankesa pretendon se aktgjykimi i kundërshtuar tejkalon aktakuzën lidhur me dënimin për kryerjen vrasjes së rëndë për motive të ulëta.

Si rezultat i cilësimit juridik të veprës penale këto pretendime janë vjetruar.

E njëjta vlen edhe për pretendimin se dispozitivit i mungon përshkrimi faktik i motiveve të të pandehurit.

Sa i përket argumentit se aktgjykimi nuk ishte përpiluar në pajtim me nenin 370 të KPP-së pasi që i mungon data e përpilimit, kolegji pajtohet plotësisht me arsyetimin a Gjykatës së Apelit. Mungesa e datës së përpilimit është mangësi shume e vogël në formën e aktgjykimit të shkruar në përputhje me nenin 371 paragrafin 1 të KPP-së. Kjo nuk i shkakton asnjë pengesë të pandehurit.

Mbrojtja po ashtu e përsërit argumentin tashmë të ngritur në ankesën kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë se dispozitivi gabimisht përmend veprat penale të kryera “në bashkëkryerje”. Po ashtu Gjykata Supreme në mungesë të një deklarimi të tillë në dispozitiv plotësisht i bindet arsyetimit të Gjykatës së Apelit. Dispozitivi përmend se i pandehuri ka kryer dy vepra penale “në bashkim.” Kolegji i referohet nenit 71 të KPK-së dhe nenit 80 të KPRK-së.

c. Shkeljet e ligjit penal

Lidhur me dënimin për veprën penale të mbajtjes në pronësi, në kontroll apo në posedim të paautorizuar të armëve në shkelje të nenit 374 paragrafit 1 të KPRK-së, mbrojtja parashtrohet se kjo veprë penale është e përfshirë në Ligjin për Amnistinë dhe se kjo akuzë duhet të hedhet poshtë.

Kolegji pajtohet me argumentin e mbrojtjes dhe në përputhje me nenin 402 paragrafin 2 në lidhje me nenin 358 nën-paragrafin 1.3. të KPP-së ka hedhur poshtë akuzën.

Edhe pse aktakuza e ngarkon të pandehurin për veprën penale të mbajtjes në pronësi, në kontroll, në posedim apo në shfrytëzim të paautorizuar të armëve në shkelje të nenit 328 paragrafit 2 të KPK-së, Gjykata Themelore ka cilësuar këtë veprë si mbajtje në pronësi të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 i KPRK-së pa sqaruar *ratio* në arsyetim.

LIGJI NR. 04/L-209 PËR AMNISTINË i ka shënuar të dyja veprat penale në nenin 3 (nën-paragrafin 1.1.10. dhe 1.2.5.) si të liruar nga ndjekja penale dhe nga ekzekutimi i dënimit.

Neni 4 nën-paragrafi 1.3. i Ligjit për Amnistinë përcakton se:

“Amnistia nga cilado veprë penale e përmendur në këtë ligj nuk do të aplikohet për ...veprat penale që kanë rezultuar me lëndim të rëndë trupor ose me vdekje.”

Me qëllim të përcaktimit nëse një veprë penale ka “rezultuar” me ndonjërin nga rezultatet e rënda të përmendura më lart, kolegjit i është dashur ta zbatojë një kriter të thjeshtë shkakor: A kishte veprimi i kryerësit *conditio sine qua non* për rezultat – vdekjen e viktimës?

Cilësimi fillestar juridik në aktakuzë ka përfshirë në mes tjerash edhe alternativën faktike të “shfrytëzimit” të armës gjersa cilësimi juridik i zbatuar nga gjykata nuk inkorporon këtë

alternativë faktike. Aktgjykimi i kundërshtuar, edhe pse në përshkrimin faktik të dispozitivit përshkruan se i pandehuri "...qëllimisht ka përdorur AK-47 ..." ai qartazi e cilëson më vonë veprën penale vetëm si "Posedim i paautorizuar".

Gjykata e Apelit, pas ankesave të paraqitura nga Prokurori i Shtetit dhe nga mbrojtja, nuk arriti ta ndryshojë cilësimin juridik të kësaj vepre penale.

Kolegji në fazën e tanishëm të procedurës, me zbatimin e restriksionit të *reformatio in peius* (neni 407 paragrafi 2 në lidhje me nenin 395 *mutatis mutandis* të KPP-së), është i detyruar nga cilësimi i lartpërmendur juridik.

Vetëm veprimi i posedimit të armës nuk ka shkaktuar vdekjen e viktimës R. A. Prandaj, vepra penale në pyetje është e mbuluar me nenin 3 nën-paragrafin 1.1.10. të Ligjit për Amnistinë. Lirimi nga neni 4 nën-paragrafi 1.3. i Ligjit për Amnistinë nuk vlen.

d. Vendimi mbi sanksionin penal

Për caktimin e sanksionit penal për veprën penale të vrasjes në kundërshtim të nenit 146 të KPK-së Gjykata mori parasysh rrethanat rënduese në vijim:

Vrasja ishte kryer në mes të ditës, në sheshin publik para Xhamisë së fshatit dhe para shumë njerëzve të tjerë. Po ashtu janë marrë parasysh edhe teksti i mesazhit i shkruar me një gjuhë shumë poshtëruese i dërguar vajzës së viktimës së ndjerë, ish-gruas së të pandehurit.

Në favor të të akuzuarit Gjykata mori parasysh se është lajmëruar në polici pak kohë pas kryerjes së veprës penale dhe se ka bashkëpunuar me prokurorinë dhe gjykatën gjatë procedurës penale. Gjykata po ashtu ka gjetur faktorë lehtësues në gjendjen personale të të pandehurit. Është baba i fëmijëve të mitur të cilit ishin nën përkujdesjen e tij që nga momenti kur gruaja e tij vendosi të jetojë e ndarë. Ai duhej të kujdesej jo vetëm për fëmijët, por edhe për babanë e tij të paralizuar i cili kërkonte kujdes të përhershëm të personit të tretë. Këto elemente tregojnë elemente pozitive të personalitetit të tij të cilat nuk mund të injorohen gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin.

Duke u nisur nga korniza e dënimit në mes pesë (5) dhe njëzet (20) vitesh burgim të përcaktuar me nenin 146 në lidhje me nenin 38 paragrafin 1 të KPK-së, kolegji vendosi se dënimi me shtatëmbëdhjetë (17) vjet është proporcional me peshën e veprës penale, me rrethanat rënduese dhe lehtësuese, me sjelljen e të pandehurit pas kryerjes së veprës penale dhe me gjendjen e tij personale.

Në përputhje me nenin 73 paragrafin 1 të KPK-së, koha që A. C. ka kaluar në paraburgim duhet të llogaritet në dënimin me burgim të shqiptuar kundër tij.

Duke u bazuar në arsyet e sipërpërmendura, në përputhje me nenin 430 paragrafin 1 nën-paragrafin 1 të KPPK-së *mutatis mutandis*, në lidhje me nenin 407 paragrafin 2, 403 nën-paragrafin 1.2 të KPP-së 1.2, Gjykata Supreme e Kosovës vendosi si në dispozitiv.

Përpiluar më 9 dhjetor 2015 në gjuhën angleze.

Anëtarët e kolegjit:

Gyltene Sylejmani
Gjyqtare e Gjykatës Supreme

Anna Adamska-Gallant
Gjyqtare e EULEX-it

Kryetare e kolegjit

Elka Filcheva-Ermenkova
Gjyqtare e EULEX-it

SAKTËSINË E KOPJES
TACNOST OTPRAVKA
Procesmbajtës

Holger Engelmann
Zyrtar ligjor i EULEX-it

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
PAIL.-KŽII. Nr. 5/2015
26 tetor 2015
Prishtinë

Mendim i pjesshëm mospajtuës i gjyqtarës Elka Filcheva-Ermenkova, kryetare e kolegjit dhe gjyqtare referuese, sa i përket ri-cilësimit të veprës penale vrasje e rëndë nga hakmarrja e paskrupullt në veprën penale vrasje:

1. Nuk pajtohem me mendimin e shumicës së kolegjit se krimi duhej të ri-cilësohej nga vrasje e rëndë e kryer nga hakmarrja e paskrupullt nga neni 147 (1.9) në vrasje nga hakmarrja nga neni 146.
2. Pikënisja e sqarimit të pikëpamjeve të kundërta se si është dashur të ri-cilësohet kjo veprë penale duhet të jetë përshkrimi i rrethanave të ndryshme faktike të dy krimeve të ndryshme, të dyja vrasje.
3. Cilësimi themelor i vrasjes është dhënë nga ligjvënësi në nenin 146 të KPK-së (kodi material penal). Nuk ka nevojë të përshkruhet se cilat janë elementet objektive dhe subjektive të tij. Nuk ka nevojë as të sqarohet se vrasja nga hakmarrja mund të cilësohet nën hipotezën themelore të nenit 146. Ligjvënësi e ka definuar si vrasje të kryer nga hakmarrja e paskrupullt vrasjen e cilësuar nga neni 147 (1.9). Është parim themelor që fjalët e përdorura në ligj duhet të kuptohen sipas domethënies së zakonshme të tyre përveç kur ekziston një kuptim specifik që i jep vetë ligji. Në ligjin material penal fjala "i paskrupullt" bart kuptimin e njëjtë si në jetën e përditshme, është një mbiemër që ka kuptimin të mos kesh ose të mos shfaqësh asnjë parim moral, të mos jesh i ndershëm apo i drejtë. Disa sinonime të mbiemrit 'i paskrupullt' janë: i pamoralshëm, jo etik, i paturpshëm etj. Lista mund të jetë shumë e gjatë. Në atë kontekst lingvistik është e dobishme të kërkohet një sqarim në pyetjen kur hakmarrja nuk do të ishte e paskrupullt, ose e pamoralshme, ose jo etike, ose e paturpshme. Përgjigja logjike do të ishte kur hakmarrësi kishte arsye të mirë për t'u hakmarrë, për ta kthyer goditjen. Për shembull kur viktimja e vrasjes ishte i pari që ka kërcënuar integritetin fizik të vrasësit ose të të afërmeve të tij/saj ose që për një kohë të gjatë ka ngacmuar apo torturuar vrasësin ose ka krijuar kushte të pamundshme të jetesës për vrasësin. Në rastin konkret mbrojtja pretendon se viktimja, babai i ish-gruas së të pandehurit kishte ndërhyrë vazhdimisht në jetën e qifit të martuar dhe ishte arsyeja e vetme që ish-gruaja nuk ishte kthyer te burri i saj dhe kjo është paraqitur si arsye mjaft e mirë për cilësimin e vrasjes së viktimës si hakmarrje e cila në asnjë mënyrë nuk është kryer nga arsye të paskrupullta.
4. Për këtë arsye ishte me rëndësi që së pari të vlerësohej nëse viktimja ishte apo nuk ishte disi duke ushtruar ndonjë lloj ngacmimi apo torture (të natyrës fizike ose psikologjike kundrejt të pandehurit ose të afërmeve të tij – motrave apo prindërve të tij); së dyti, nëse viktimja po e pengonte vajzën e tij që të kishte jetë normale martesore me burrin e saj (të pandehurin) dhe së treti, nëse e para apo e dyta do të justifikonte hakmarrjen e drejtë në formë të vrasjes. Përndryshe, nëse nuk e justifikojnë, atëherë vrasja lehtë do të cilësohej si vrasje e kryer nga hakmarrja e paskrupullt. Do të thotë që i pandehuri nuk ka mundur assesit të pranohet faktin se gruaja e tij nuk dëshiron të jetojë më tutje me të dhe me qëllim që ta "dënojë" atë dhe/ose babanë e saj ai vendosi ta vrasë këtë të fundit dhe kjo është qartazi e pamoralshme, jo etike, e paturpshme dhe e paskrupullt.
5. Në këtë aspekt duhet të kthehemi te faktet e çështjes, të cilat janë vërtetuar si në vijim:

6. Marrëdhëniet në mes të pandehurit Z. A. C. dhe vjehrrit të tij, të ndjerit R. A. ishin damkosur me një armiqësi të vërtetë, si pasojë e gjendjes së keqe të jetës martesore të të pandehurit me vajzën e viktimës, Znj. Q. A. Nuk është e diskutueshme se gjendja martesore e Q. A. dhe burrit të, të pandehurit C. ishte larg nga të qenit e lumtur dhe e shëndetshme. Përkundrazi, jeta e tyre martesore ishte nxirë pas mosmarrëveshjeve të vazhdueshme dhe dhunës sporadike fizike, të ushtruar nga burri i saj. I pandehuri e jep arsyetimin e tij lidhur me këtë gjendje. Sipas fjalëve të tij, ai ishte i "burgosur" për shkak të "gruas së tij" dhe kjo ishte e padrejtë sepse ajo nuk ishte lënduar për shkak të "dy shuplakave" që ia kishte dhënë, por për shkak se kishte kërcyer nga dritarja. Historiku i ndarjes së qiftit në të kaluarën dhe më pas bashkimit të tyre e më pastaj përsëri të ndarjes nuk është e diskutueshme. Është e njohur se Q. A. kishte lënë njëherë burrin, e pas pak ishte bashkuar me të nën kulmin e shtëpisë së tij dhe më vonë prapë kishte ikur.
7. Në këso rrethanash, i ndjeri R. A. mbështeti vendimin e vajzës së saj dhe nuk e detyroi atë të ribashkohej me burrin e saj përveç nëse këtë e vendoste vetë. Përveç kësaj në disa raste R. A. kishte shfaqur antipati gati një armiqësi të pastër ndaj familjes së të pandehurit. Për shembull, motrat e të pandehurit A. dhe M. C. të dyja dëshmuuan se në disa raste të ndryshme i ndjeri A. nuk ishte sjellë në mënyrë të mirë dhe me dinjitet me asnjërin nga to. Vinte në shtëpinë e familjes së tyre (në shtëpinë e familjes C. dhe përdorte gjuhë nënçmuese, duke implikuar se njëra nga to ose duhej të dilte nga shtëpia për t'i lënë më shumë hapësirë gruas së A. pra vajzës së tij. Megjithatë kurë nuk është vërtetuar se kjo armiqësi kishte shkuar përtej fjalëve të thëna në disa raste të rralla.
8. Është e njohur se mosmarrëveshjet në mes A. dhe Q. që u bënë mosmarrëveshje në mes të familjeve A. dhe C. shtrënguan të pandehurin të kërkojë ndihmë nga një ndërmjetësues, një imam vendas, i cili dëshmoi para Gjykatës Themelore. Dëshmitari pohoi se ishte arritur pajtimi për një kohë të caktuar, por me gjasë pas kësaj si pasojë e mosmarrëveshjeve në mes të fëmijëve të tyre të martuar prapë familjet u prishën në mes vete. Ndërmjetësuesi dëshmoi se as i ndjeri A. e as i pandehuri nuk ishin persona të rrezikshëm. U kërkua një sqarim pas as pohimit të bërë nga i pandehuri se po mbante AK 47 kur shkoi ta takonte R. sepse ky i fundit ishte "person i rrezikshëm", i cili gjithmonë mbante armë. Ky pretendim mbeti plotësisht i pavërtetuar. Asnjëherë nuk është vërtetuar se i ndjeri A. ishte mbajtur armë ndonjëherë.
9. Për të dhënë një pasqyrë të plotë të qëndrimeve zemërliga gjykata potencon se dy fëmijët e mitur të qiftit mbetën me babanë e tyre, të pandehurin C., nën përkujdesjen e hallave të tyre (motrave të të pandehurit). Është vërtetuar se Q. A. nuk ka kërkuar kujdestarinë e fëmijëve të saj. Sipas saj, këtë e kishte bërë sepse nuk kishte asnjë mundësi të kujdesej për fëmijët kurse sipas të pandehurit këtë e kishte bërë sepse ishte nënë e keqe. Këto fjalë të caktuara nuk ishin përdorur asnjëherë por ky koncept padyshim ishte lënë të kuptohej nga i pandehuri dhe motrat e tij, të cilat dëshmuuan në këtë gjykim. Megjithatë, arsyeja e vërtetë që Q. A. nuk kishte kërkuar kujdestarinë e fëmijëve në asnjë mënyrë nuk e reflekton natyrën e krimit dhe kjo është përmendur vetëm për shkak se mbrojtja ishte shumë e përkushtuar në të dy

instancat e procedurës gjyqësore që t'i theksojë cilësitë e nënës ose mungesën e këtyre cilësive në ish-gruan e të pandehurit. Çfarëdo cilësish që i ka apo nuk i ka asnjëra nga këto nuk e ndryshon faktin se i pandehuri e ka vrarë babanë e saj dhe asgjë nuk e arsyeton hakmarrjen, sepse a ishte ajo nënë e mirë apo e keqe nuk mund të jetë arsye "e drejtë" për t'u hakmarrë kundër jetës së babait të saj.

10. Nuk është kontestuese që si rezultat i kësaj atmosfere armiqësore të mosbesimit të ndërsjellë, zemërimit dhe mos-durimit i pandehuri është ndjerë i zemëruar, tejet nervoz, i frustruar, në përgjithësi i kapluar nga emocionet negative. Për disa arsye ai ka besuar, ose të paktën pretendon se ka besuar, se po të mos ishte ndikimi i vjehrrit të tij, gruaja e tij Q. [REDACTED] do t'i kthehej atij dhe do të jetonin të lumtur së bashku. Ai ka qenë i bindur se i ndjeri R. [REDACTED] A. [REDACTED] ka qenë shkaktari i vetëm i martesës së tyre të palumtur. Ai në disa raste ka përsëritur se gruaja e tij ka qenë nën ndikimin e plotë të babait të saj dhe se nuk e ka pasur vullnetin e saj të lirë në këtë çështje. Përveç kësaj, i pandehuri është i sigurtë në besimin e tij se ai asnjëherë nuk i ka bërë asgjë të keqe gruas së tij. Ai gjithashtu para Gjykatës Themelore (në mbrojtjen e tij) ka pohuar se vjehrrin e tij i ndjerë ka dashur ta martojë vajzën e tij me një njeri më të pasur për t'i paguar borxhet e tij. Ky pretendim asnjëherë nuk është mbështetur me ndonjë provë.
11. Siç është cekur më lart, në dosje nuk ka asnjë provë se i ndjeri R. [REDACTED] A. [REDACTED] ka sulmuar ndonjëherë fizikisht të pandehurin apo ndonjë anëtarë tjetër të familjes së tij. Përveç deklaratës së dhënë nga motrat C. [REDACTED] e i kishte "ftuar" që të lirojnë hapësirën në shtëpi për vajzën e tij, nuk ka asnjë provë se ai ka qenë tepër fyes, i bezdisshëm apo agresiv në lidhje me këtë (shih paragrafin 7 *supra*).
12. Në këtë gjendje faktike të gjërave, i pandehuri në pikë të ditës, ka marrë pushkën e tij AK-47 dhe në mes të ditës ka shkuar para xhamisë dhe ka qëlluar vjehrrin e tij. Është thjeshtë vetëm rastësi që askush tjetër nuk është lënduar, sepse personat e tjerë ende nuk kishin dalë nga xhamia.
13. Rezulton se i pandehuri për përgjigje të dëmit të cilin ka besuar (apo të paktën ka pretenduar se ka besuar) se vjehrrin e tij ia ka shkaktuar duke e mbështetur vajzën e tij; i pandehuri i është hakmarrë (ish gruas së tij dhe/ose babait të saj) duke shtënë për të vrarë.
14. Dhe këtu kthehemi në pikën e krahasimit të vrasjes nga hakmarrja dhe vrasjes nga hakmarrja e paskrupullt, e dyta duke qenë vrasje e rëndë, pra një hipotezë e cilësuar e cila do të dënohej më ashpër.
15. Siç është cekur më herët, (paragrafi 3), çdo herë kur hakmarrja shkaktohet nga dëmi real i shkaktuar (apo perceptimit real të dëmit të vërtetë të shkaktuar) ndaj të pandehurit dhe ai kundërpërgjigjet me hakmarrje, elementi i paskrupullt, imoraliteti etj., nuk do të ishin të pranishëm. Për shembull: viktima mundohet të vret të akuzuarin/pandehurin, por nuk ka sukses, i dyti i hakmerret më vonë dhe e vret (më vonë, sepse po të ishte në atë moment në atë të nxehtë për shembull do të mund të ishte vetëmbrojtje). Ose, viktima e vret apo mundohet ta vrasë apo t'i shkaktojë lëndime të rënda trupore ose tenton t'ia bëjë këtë dikujt të afërt të të akuzuarit dhe ky i fundit hakmerret. Këta janë vetëm shembuj; jeta ka mundësi të shumta të cilat nuk mund të shterohen në një mendim të gjykatës.

16. Në këtë lëndë i pandehuri, duke perceptuar dëmin e shkaktuar ndaj tij nga vjehri i tij (ose pretendon se ka besuar se i është shkaktuar dëmi), është hakmarrë duke e vrarë atë.
17. Së pari, nuk ka asnjë provë se vjehri i tij ka qenë arsyeja e shkatërrimit të familjes së të pandehurit dhe së dyti edhe nëse ka qenë tejet përkrahës i vendimit të vajzës së tij për të mos u kthyer tek burri saj, pra duke e motivuar, përtej dëshirës së saj për të mos u kthyer, kjo nuk do të ishte arsye e justifikueshme për hakmarrje vdekjeprurëse.
18. Përkitazi me këtë, më duhet të theksojë se pikëpamja e kolegjit se nuk ka asnjë provë për hakmarrjen e "paskrupullt" është e gabuar. Nëse hakmarrja është e paskrupullt është një cilësim i cili bëhet me vërtetimit apo mos-vërtetimin e faktit pozitiv të dëmit të shkaktuar nga viktima ndaj të pandehurit, për të cilin ai vetë është hakmarrë.
19. **Në këtë lëndë nuk ka asnjë provë për dëmin e supozuar të shkaktuar nga R. A. mirëpo shumica e kolegjit e ka marrë parasysh si relevante faktin se nuk ka pasur prova për mungesën e atij dëmi. Ky është një gabim logjik, sepse askush nuk mund të paraqes prova mbi mungesën e diçkaje.** Me aktakuzën për vrasje të rëndë nga hakmarrja e paskrupullt pretendimi i Prokurorisë nënkupton se nuk ka pasur asnjë arsye të justifikueshme për hakmarrje dhe për këtë arsye vrasja nuk është thjeshtë vetëm një vrasje nga hakmarrja por është vrasje nga hakmarrja e paskrupullt, që është motiv i ulët (*per argumentum* sipas nenit 147(1.9). Gjatë procedurës penale nuk ka pasur asnjë arsye për të besuar se Prokuroria është duke fshehur prova të cilat mund të çojnë në përfundim se i ndjeri R. A. i ka shkaktuar dëm dhëndrit të tij, përkatësisht se ai ka qenë arsyeja për shkatërrimin e martesës dhe ai ka qenë arsyeja për helmimin e jetës së tij familjare në përgjithësi. Prokuroria nuk ka paraqitur asnjë provë të tillë sepse sipas mendimit tim një provë e tillë nuk ka ekzistuar. Në anën tjetër, i pandehuri është përfaqësuar nga një avokat shumë i kualifikuar i cili ka mundur të kërkojë mbledhjen e provave shtesë të cilat do të vërtetonin pretendimin për ndërhyrjen dhe agresivitetin e të ndjerit A. Në vend të kësaj, ai ka pretenduar se nuk ka asnjë provë për hakmarrje të paskrupullt, që nënkupton se ekzistojnë prova dëmin e shkaktuar nga viktima, por se ky dëm asnjëherë nuk është vërtetuar
20. Përveç kësaj, edhe nëse në mënyrë hipotetike e pranojmë se duke përkrahur vajzën e tij R. A. ka qenë shkaktari kryesor për fatkeqësinë martesore të të pandehurit, kjo nuk do të ishte arsye e justifikueshme për të vrarë (është e ditur që shpeshherë vjehrit, dhëndurët dhe nuset nuk shkojnë mirë mes tyre, por zakonisht ata nuk vriten në mes vete). Q. A. nuk ka qenë e mitur përderisa të vërtetohet ndryshe, ajo merret vendimet e veta madje edhe kur është përkrahur nga prindërit e saj, prapëseprapë ka qenë vendimi i saj që të largohet. Prandaj, hakmarrja në formën e vrasjes së vjehrit të pretenduar ndërhyrës në mënyrë të qartë është hakmarrje jo proporcionale. Dhe vetëm ky jo proporcionalitet i madh jep arsye të mjaftueshme që vrasja të cilësohet si e paskrupullt (përveç faktit se çdo hakmarrje e padrejtë në kuptimin moral do të mund të cilësohet e paskrupullt— shih paragrafin 3 *supra*). Qartazi, i pandehuri beson se ish gruaja e tij nuk është në gjendje të marrë vendimet vetë dhe se ajo gjithmonë ka nevojë që të udhëzohet nga dikush tjetër, preferohet nga burri i saj. Është e qartë se ai nuk e pranon mundësinë që ajo mund t'i marrë vendimet e saj vetë. Kjo e fundit nuk lidhet drejtpërdrejtë me veprën penale në fjalë por demonstroi atë që kanë thënë psikologu

dhe psikiatri para Gjykatës Themelore, se ai është person egocentrik, që nënkupton se ai nuk e çmon vullnetin dhe dëshirat e të tjerëve, por vetëm të vetat, një sjellje thellësisht e papranueshme në një shoqëri moderne.

Në bazë të argumenteve të lartpërmendura konsideroj se gjykatat e shkallës së parë dhe dytë i kanë vënë cilësimin e duhur dhe vendimi edhe pse nuk është arsyetuar në mënyrë të shtjelluar është dashur të mbështetet në tërësi në pjesën ku vepra penale është cilësuar si vrasje nga hakmarrja e paskrupullt. Përderisa cilësimi është ndryshuar në cilësim më të butë, do të ishte jo-relevante që vlerësohet nëse dënimi i shqiptuar nga Gjykata Themelore mbi bazën e premisave se vrasja ka qenë e cilësuar, është përcaktuar në mënyrë të drejtë

Gjyqtarja Elka Filcheva-Ermenkova

27 tetor 2015